3. MATERIALET PËR PRODHIMIN E PNEUMATIKËVE

Pneumatiku përbëhet prej disa komponentëve të ndryshme, secila prej tyre përmban elementet me përbërje të ndryshëm. Këto përbërës ndryshojnë varësisht nga lloji dhe dimensionimi i pneumatikëve. [3]

Në tabelën 10 janë dhënë elementet e përdorura për prodhimin e pneumatikut 315/80 R 22.5 HSL . Ky pneumatikë peshon afërsisht 62 kg (fig. 16).



Figura 16. Pneumatiku 315/80 R 22,5 HSL

Tabela 10. Komponentët strukturale të pneumatikut 315/80 R 22,5 HSL, në përqindje dhe në masë/ [3]

	Përmbajtja	Pesha [kg]	%
1	Gomë natyrale	18.8	30.5
2	Gomë sintetike	3.4	5.6
3	Gomë Halogen butyl	1.23	2
4	Kemikalje tjera (plastifikues, preservative, agjente vulkanizues)	17.3	28.1
5	Fije mbajtëse (fije çeliku të shtresuara)	8.5	13.8
6	Najlon i fabrikuar	0.12	0.2
7	Fije mbajtëse (fije çeliku të shtresuara, standarte)	12.2	19.8

3.1. Komponentët e pneumatikut dhe funksionet e tyre

Komponentët e pneumatikut janë treguar në fig. 17:




Figura 17. Pjesët përbërëse të pneumatikut (1. Shtresa shkelëse e pneumatikut; 2. Shiriti shumë shtresor nga çeliku; 3. Struktura e çelikut; 4. Shtresat e brendshme; 5. Faqja anësore (anësoret); 6. Thembra; 7. Rrethi) [3]

1. Shtresa shkelëse e pneumatikut- protektori

Sipërfaqja shkelëse - është pjesa e pneumatikut e cila drejtëpërdrejt vjen në kontakt me shtresën e rrugës. Materiali prej të cilit punohet shtresa shkelëse është me përbërje të gomës. Shtresa shkelëse duhet të ofrojë rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe koeficient të lartë të ngjitjes (athezionit) në të gjitha kushtet rrugore. Në disa raste shtresa shkelëse kombinohet nga dy materiale të ndryshme (baza dhe kurora). Baza ka për detyrë që ti minimizojë temperaturat dhe rezistencat e rrokullisjes.

2. Shiriti shumë shtresor nga çeliku

Materiali prej të cilit punohen janë fije të çelikut të mbështjella me material gome. Shiriti shumë shtresor nga çeliku ka për detyrë që ta rritë stabilitetin gjatë ngasjes, ta zvogëlon rezistencën në rrokullisje dhe ti zgjatë jetën (afatin e shërbimit) pneumatikut. Kufizon rritjen e skeletit mbajtës-karkasës si dhe rrit aftësinë bartëse të strukturës së pneumatikut.

3. Struktura e çeliktë

Materiali prej të cilit punohet janë fije të çeliktë. Struktura e çeliktë i jep pneumatikut fortësinë dhe karakteristikat përkulëse të sajë. Definojnë komoditetin e ngasjes.

Karkasa - paraqet shtresën e armiruar të pneumatikut, e cila siguron integritet struktural në kushtet e veprimit të presionit të brendshëm.

Dallojmë disa shtresa të pneumatikut të jashtëm prej të cilave më e rëndësishme është shtresa shkelëse (protektori) e cila gjithnjë në vete ka larat kundër rrëshqitjes së rrotës.

4. Shtresat e brendshme

Materiali prej së cilit punohen kanë përmbajtje gome. Shtresat e brendshme janë faktor kryesor në mbajtjen e presionit dhe pengimit të depërtimit të lagështisë brenda pneumatikut.

5. Faqja anësore (anësoret)

Ana – është pjesë e pneumatikut në mes shtresës shkelëse dhe shputës së pneumatikut. Në anën e pneumatikut gjenden të gjitha shenjat dhe shënimet e pneumatikut.

Materiali prej të cilit punohen kanë përmbajtje gome. Funkcioni i faqes anësore (anësoret) është evitimi i gërryerjes anësore dhe ndikimeve atmosferike.

6. Thembra

Materiali nga i cili përbëhet thembra është *Naylon*, *Aramid* dhe *fije çeliku*. Kurse funksioni i thembrës është të siguron skajoret e shtresave të çelikta për përputhje me mbështetëset.

7. Rrethi

Materiali i rrethit është fije çeliku të mbështjella me lëndë gome, dhe funksioni i tij është të siguron mbështetjen e pneumatikut në skajore.

- **Brejker (shtresa përforcuese)** - dy e më tepër shtresa të gumizuara të kordeve, të vendosura në periferi nën sipërfaqen shkelëse. Detyra kryesore e saj është përforcimet plotësuese të karkasës dhe shtresës shkelëse.
- **Shputa** - është pjesë e pneumatikut e cila duhet ti përshtatet profilit të diskut, ku detyra kryesore e tij është ta mbaj pneumatikun të lidhur fort për disku.

4. RICIKLIMI

Riciklimi paraqet çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave. [5]

Të mirat që përfitojmë nga riciklimi

1. Parandalon ndotjen e ajrit të krijuar nga prodhimi i produkteve të reja,
2. Kursen energjinë për prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e këtyre produkteve,
3. Ul emetimin e gazeve serë të cilat ndikojnë në ngrohjen globale, ose ndryshimin e klimës, me ndikim në të ardhmen e zhvillimit të qëndrueshëm,
4. Mbron burimet natyrore si psh: pyjet, ujrat, pasuritë nëntokësore, (metalet dhe nafta/lëngjet fosile) etj.

4.1. Mbeturinat dhe ndarja e tyre

Mbeturina është një substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar t'a hedh. [5]

Menaxhim i mbeturinave paraqet aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve. [5]

Përpunim i mbeturinave është operimi, ku rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet tjera të cilat përndryshe do të duhej përdorur për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo ekonominë e gjerë. Është shumë e rëndësishme që në fillim të ndahen mbeturinat sipas llojit (fig. 18). Shumica e materialeve mund të përdoren përsëri nëse mblidhen veçanërisht dhe grumbullohen në mënyrë të duhur. [5]

Pra, procesi i riciklimit fillon me grumbullimin e veçantë të mbeturinave në kontenierë dhe pastaj me kamionet e shërbimeve komunale transportohen për në qendër për riciklim ku fillon procesi i seleksionimit të llojeve të ndryshme të mbeturinave, dërmimi ose shkrirja e tyre me qëllim që të fitohet lënda e parë nga e cila mund të bëhen produkte të ndryshme ose mjete të cilat mund të përdoren në jetën e përditshme.



Figura 18. Ndarja e mbeturinave

Impiant është objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar. Impiantet moderne të trajtimi të mbeturinave, përfaqesojnë unazën ideale të bashkimit mes qytetarëve (që kryejnë diferencimin e mbeturinave) dhe prodhuesit final të materialit të ricikluar. [5]

Në thelb, **impiantet e seleksionimit** janë vende që "pastrojnë" mbeturinat nga grumbullimi i diferencuar dhe i nisin drejt impianteve prodhuese pa materiale të huaja. Janë fundamentale në procesin e riciklimit, pasi një nga problemet madhore në grumbullimin e diferencuar është lidhur me praninë e materialeve të huaja në tipologjitë e ndryshme të mbeturinave (për shembull qeramika tek qelqi, ose nailoni tek letra.)

Ekzistojnë impiante që pranojnë vetëm tipe të caktuara mbeturinash (për shembull, plastika), ose më tepër tipologji mbeturinash.

Udhëzimet e mëposhtme janë përcaktuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të pneumatikut duke: [4]

- Përcaktuar taksë të veçantë për importin dhe prodhimin e pneumatikëve për të mbuluar koston e menaxhimit dhe trajtimit të tyre, pasi të bëhen mbeturinë,
- Inkurajuar ripërdorimin e pneumatikëve të veçanta të përdorura,
- Mundësuar trajtimin termik të kontrolluar, kur mbeturinat e pneumatikëve nuk mund të trajtohen ndryshe (prodhimin e energjisë, konvertimit në gaz sintetik ose në vaj).




Figura 21. Prerja tërthore e pneumatikut dhe radiusi i gdhendjes

Pas gdhendjes së pneumatikut është e domosdoshme që pneumatiku të transportohet me mjete të caktuara për mbrojtjen nga ndotja deri tek punimi me dorë. Për të menjuar oksidimin e saj duhet që brenda 4 orëve të çimentohe dhe të vendoset mbi të goma lidhëse. Njëkohësisht duhet të veshet me shiritin e profiluar i cili nuk duhet të jetë më i gjërë se krahrori i pneumatikut. Karabina e veshur duhet normalisht brenda 72 orëve të vullkanizohet.

Për të menjuar gabimet e ngjitjes duhet të ju përmbahemi disa rregullave:

- nuk duhet karabina të rrotullohet në tokë,
- nuk duhet të preket me duar të zhytura,
- nuk duhet të ketë kontakt me vajra,
- karabina e gdhendur që qëndron më gjatë se 4 orë duhet prap të rifreskohet.

Në këtë vend të punës kryhen:

- Gdhendja prej dëmtimeve të jashtme,
- Riparimet e dëmtimeve të brendshme të pneumatikut,
- Kabina e injektimit,
- Mbushja e lëndimeve të jashtme me ekstruder dore,

Sistemi transportues: për bartjen e pneumatikëve nga një proces në procesin tjetër të punës nevojiten sistemet transportuese ku përmes tyre mundësohet bartja në mënyrë të sigurtë dhe efikase (fig. 22), siç janë:

- Rruga e transportit ku pneumatiku qëndron varur,
- Bartja e pneumatikut në rrota etj.



Figura 22. Transportuesi i pneumatikut

Injektimi i konfeksionit: Pneumatiku dërgohet deri te kabina ku mund të bëhet injektimi i konfeksionit automatik ose manual (me dorë). Me rëndësi është që kabina të ketë një aspirator për thithjen e gazrave që lirohen në kabinë në menyrë që të parandalohet përhapja e tyre në mjedis.

Përgatitja e shiritit të shkeljes dhe vendosja e pneumatikut lidhës: pas injektimit të konfeksionit bëhet përgatitja e shiritit të shkeljes ku do kryhen këto procese:

- Gjatësia e shiritit shkelës,
- Punimi i prerjes këndore,
- Vendosja e pneumatikut lidhës.

Është e detyrueshme që të posedohet tavolina me gjatësi prej 4 [m] dhe të jetë me një sipërfaqe të lëmuar e cila duhet të jetë e pajisur me:

- Prerësin për shiritin e pneumatikut,
- Matësin e gjatësisë dhe
- Gdhendësin e dorës.

Në vazhdim do paraqesim hapat e vendosjes së pneumatikut lidhës (fig 23 dhe fig 24):



Figura 23. Vendosja e shiritit shkelës



Figura 24. Vendosja e këndit dhe vendosja e këndit të prerë të shiritit

Veshja: Gjatë procesit të veshjes kryhen këto procese të punës (fig 25 dhe fig 26):

1. Heqja e folisë (plastikës) prej pneumatikut lidhës,
2. Vendosja e shiritit shkelës,
3. Vendosja e indit për thithjen e ajrit,
4. Sistemi i vullkanizimit me vakum dhe shtypje të nivelizuar,
5. Vendosja e shënimeve për datën e prodhimit.



Figura 25. Montimi i pneumatikut të jashtëm dhe montimi i pneumatikut të brendëshëm



Figura 26. Heqja e vakuumit

Përgatitja e ngrohjes (vullkanizimi): procesi nëpërmjet të cilit arrihet rrjetëzimi i kauçukut quhet **vullkanizim**. Vullkanizimi mund të jetë i nxehtë apo i ftohtë. Thelbi i vullkanizimit është futja e squfurit i cili bënë lidhjen anësore të molekulave zingjirore (rrjetëzon).

[16]

Vullkanizimi bëhet me nxehje disa orëshe të prodhimit në matricat prej çeliku, në temperaturë 110°C – 165°C dhe futjen e squfurit. Kjo është faza më e rëndësishme gjatë së cilës atomet e squfurit lidhin tërthorazi zingjirët e polimerit.

Vullkanizimi bëhet në autoklav, i cili duhet të jetë i paisur me:

- Treguesin e temperaturës,
- Treguesin e kohës,
- Treguesin e shtypjes, që të dokumentohet procesi i vullkanizimit të pneumatikëve gjatë punës.

Autoklavi është i paisur me ngrohës elektrik dhe njëkohësisht aspiratori i cili bën qarkullimin e ajrit në brendësinë e tij. Autoklavi është i paisur me izolim të jashtëm për mos humbjen e temperaturës. Temperatura në autoklav duhet të jetë $110 [^{\circ}\text{C}]$ - $120 [^{\circ}\text{C}]$. Në fig. 27 janë treguar pneumatikët e rigjeneruar pas kalimit nëpër proceset e cekur me lartë.



Figura 27. Pneumatikët e rigjeneruar

Kapaciteti prodhues i pneumatikëve të riveshura- të rigjeneruara është prej dyzet (40) deri dyzet e pesë (45) copë ne ditë.

Në vazhdim do paraqesim në mënyrë skematike procesin teknologjik të riveshjes së pneumatikëve (fig. 28):




Figura 28. Paraqitja skematike e riveshjes së pneumatikëve

6. METODAT E RICIKLIMIT TË PNEUMATIKËVE

Metodat më të shpeshta të riciklimit të pneumatikëve janë:[1]

- Bluarja dhe
- Piroлиза

Etapa e parë e riciklimit është bluarja, pas të cilës bëhet ndarja e materialeve sipas llojit (goma, çeliku dhe tekstili). Sipas teknologjisë së përdorur, dhe temperaturës së procesit, dallojmë dy metoda themelore të bluarjes:

- Bluarje kriogjene dhe
- Bluarje mekanike.

Përdorim më të madh në shtetet evropiane ka metoda e bluarjes mekanike.

6.1. Riciklimi i pneumatikëve me thërrmim-bluarje kriogjene

Në procesin e bluarjes kriogjene, pneumatikët fillimisht ngrihen me azot të lëngshëm në temperature **-80 °C** deri **-100 [°C]**. Në këtë temperaurë pneumatiku bëhet aq i thyeshëm sa që mund të prehet relativisht lehtë me pajisje për prerje. Në këtë gjendje, shumë lehtë ndahen nga pneumatiku pjesët e tekstitit dhe të metalit. E metë e këtij procesi është kërkesa e lartë energjetike, problemet e manipulimit dhe kryesisht shpenzimet e larta. Kokrriza e fituar me bluarje kriogjene ka sipërfaqe më të madhe në krahasim me kokrrizën e fituar me bluarje klasike.

Produkti final (granulati) ka çmim shumë të lartë të përfitimit, dhe njëkohësisht bëhet ndryshimi i vetive të pneumatikut. Për 1 [kg] pneumatikë shpenzohet rreth 0.6 [kg] azot i lëngshëm. Paraqitja skematike e riciklimit kriogjen është treguar në fig. 29.




Figura 29. Paraqitja skematike e riciklimit kriogjen [8]

Në fillim të procesit, pneumatikët thërrmohen (“bluhen”) në thërrmuese (A) deri në madhësinë 50 [mm] dhe më pas transportohen deri në tunelin ftohës (B), ku bëhet ftohja me azot të lëngshëm. Në mulli, p.sh. mulliri me çekan (C), disa nga materialet si psh. çeliku dhe goma imtësohen në fraksione me madhësi nga 0,4 [mm] deri në 0,6 [mm].

Ky ndryshim kaq i madh i fraksioneve pas procesit të bluarjes është tipik për bluarje kriogjene. Në dalje nga mulliri ndahen dhe grupohen çeliku, tekstili dhe grimcat e pluhurit (D). Më pas granulatet thahen (E) dhe bëhet ndarja-separimi (F) sipas madhësisë së kokërrizave. Më pas vazhdohet me thërrmim sekondar (G) dhe me deponim të granulatit (H).


6.2. Riciklimi i pneumatikëve me thërrmim-bluarje mekanike

Në procesin e thërrmimit mekanik në temperaturë normale, pneumatikët thërrmohen në hyrje të impiantit (pajisjes), ashtu që sigurohet prurje e vazhdueshme e pneumatikëve dhe cilësi e njëjtë. Ekziston diferencë në mes të granulateve nga pneumatikët e automjeteve të udhëtarëve dhe granulateve nga pneumatikët e automjeteve transportuese. Rëndësi të veçantë ka ndarja e pneumatikëve të vjetër, sepse pas dhjetë viteve, ato pjesërisht i humbin vetitë e tyre dhe bëhet i pamundur përdorimi i granulateve të tyre.

Pneumatikët e mëdhej (për traktor dhe automjete transportuese), telat (fijet) e çelikut mund t’i kenë me diametër deri në 8 [mm], andaj këta duhet larguar paraprakisht, sepse prania e tyre e shkurton afatshërbimin e thikave dhe tërë linjës për thërrmim. Telat e çelikut largohen duke e prerë pneumatikun për së gjati.

Pneumatikët e liruar nga telat, hudhen në thërrmuese me cilindra të dhëmbëzuar të vendosur në boshte të cilët rrotullohen me kahje të kundërt, dhe copëtohen në copa me madhësi 4 [cm] x 5 [cm]. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të prodhimit, ky process përsëritet dy deri në tri herë. Në pjesën tjetër të linjës në thërrmuese me cilindra të dhëmbëzuar të vendosur në boshte të cilët rrotullohen me kahje të kundërt, granulatet e mëdha prap thërrmohen në copa të vogla, me ç'rast bëhet ndarja e pjesëve metalike nga pjesët e pneumatikut. Në dalje të linjës bëhet ndarja e pjesëve metalike me përdorimin e elektromagnetit.

Operacioni tjetër i përpunimit është thërrmimi i materialit të fituar në madhësi nga 0,4 [mm] deri në 4 [mm]. Produkti kryesor i përpunimit mekanik është granulati i pneumatikut me fraksione (madhësi) të ndryshme, pluhuri i gomës, teli i prerë i çeliku dhe tekstili i prerë. Fraksionet e fituara me përpunim mekanik mund të krahasohen me fjollat e borës, sepse i ngjajnë përnga pamja e sipërfaqes. Për fraksione me sipërfaqe të madhe më e përshtatshme është përpunimi kimik. Paraqitja skematike e riciklimit mekanik është treguar në fig. 30.



- A- Thërrmuesja
- B- Granulati
- C- Elektromagneti
- D- Bluarja pasuese
- E- Transportimi i bluarjes
- F- Separimi
- G- Deponimi
- H- Aspiratori

Figura 30. Paraqitja skematike e riciklimit mekanik të pneumatikëve [8]

Thërrmuesja (A) e bënë thërrmimin e materialit, i cili më pas lëviz nëpër shirtin transportues. Granulatori (B) i zvogëlon copat e pneumatikut dhe e mundëson ndarjen e materialit të përzier, në atë mënyrë që tekstili tërhiqet (thithet) me ndihmën e aspiratorit (H), kurse çeliku tërhiqet nga elektromagneti (C). Bluarja pasuese (D) e sjell granulatin në kokërriza me madhësi të dëshiruar.

Materiali thërrmohet në temperaturë normale, kështu që me qëllim të ngurtësimit nuk ka nevojë për ndonjë ftohje shtesë. Temperatura në të cilën materiali riciklohet arrihet përmes fërkimit i cili zhvillohet brenda mullirit.

Në fig.31 është paraqitur riciklimi i pneumatikëve me thërrmim mekanik.

vaj për djegie, 37 [%] gaz dhe 5 [%] karbon. Humbjet përbëhen nga 2-3 [%] hi dhe 5-6 [%] nxehtësi.

Shfrytëzimi i tillë i mbetjeve të pneumatikëve është me interes nga aspekti ekonomik edhe ai ekologjik, sepse i tërë procesi teknologjik paraqet një cikël të mbyllur i cili zhvillohet pa emitim të dëmshëm në atmosferë dhe pa ndotje të ujit dhe tokës.

6.4. Riciklimi i pneumatikëve në fabrikën Stagova

Pneumatikët të cilët janë shumë të dëmtuar dhe nuk mund të i nënshtrohen procesit të riveshjes si dhe pneumatikët mbeturinë, do i nënshtrohen procesit të përpunimit – riciklimit. Proceset teknologjike që zhvillohen në fabrikën **Stagova** në **Ferizaj** për riciklimin e pneumatikëve janë:

1. Prerja e rrethit të pneumatikut,
2. Zhveshja e pneumatikut,
3. Prerja e pneumatikut në copa (kube),
4. Copëtimi i pneumatikut,
5. Thërrmimi i granulatit të pneumatikut,
6. Transportuesit e granulatave,
7. Devulkanizeri,
8. Rafinimi.

Përmes figurave dhe tabelave në vazhdim do paraqesim makineritë që përdoren gjatë procesit të riciklimit të pneumatikëve në fabrikën Stagova si dhe karakteristikat kryesore të tyre.



Figura 33. Makina për prerjen e rrethit të pneumatikut

Tabela 11. Karakteristikat themelore të makinës për prerjen e rrethit të pneumatikut

Emërtimi	Parametrat teknik
Fuqia e motorit	5.5 [kW]
Shpejtësia e rrotullimit	46.8 [rr/min]
Diametri i tubit	1200 [mm]
Madhësia	1100x900x1700 [LxWxH]



Figura 34. Makina për zhveshjen e pneumatikëve

Tabela 12. Karakteristikat themelore të makinës për zhveshjen e pneumatikëve

Emërtimi	Parametri teknik
Fuqia e motorit	5.55 [kW]
Diametri i diskut	380 [mm]
Shpejtësia e rrotullimit	18.4 [rr/min]
Madhësia	1290x870x1550 [LxWxH]

Procesi i copëtimit bëhet në makineri të rënda dhe të fuqishme. Këto makineri përdorin thika/tehe të mprehëta, që shkaktojnë copëtime të pneumatikut në shirita pneumatikut dhe largojnë fibrat e çelikut prej saj. Në mënyrë që çeliku të ndahet nga elementët e tjerë magnetikë, nevojiten magnetë të fuqishëm.



Figura 35. Makina për thërmimin e pneumatikëve

Tabela 13. Karakteristikat themelore të makinës për thërmimin e pneumatikëve

Emërtimi	Parametri teknik
Diametri frontal	400 [mm]
Diametri i pasmë i cilindrit	400 [mm]
Gjatësia e punës së cilindrit	600 [mm]
Shpejtësia frontale e sipërfaqes	17.32 [m/min]
Fraksioni	1:1.38
Hapja max.	8 [mm]
Fuqia e motorit	45 [W]



Figura 36. Makina për vullkanizimin e pneumatikut (furra)

Tabela 14. Karakteristikat themelore të makinës për vullkanizimin e pneumatikut

Emërtimi	Parametri teknik
Modeli dhe specifikacioni	DTG-1400×3400A
Diametri i brendshëm i vulkanizerit	1400 [mm]
Gjatësia e punës së vulkanizerit	3400 [mm]
Presioni punës së vulkanizerit	2.2 [MPa]
Temperatura e punës	230 [°C]
Ngrohja mesatare	Avulli-gazi
Materialet e mëdha në shtypje	16 [MnR]
Klasifikimi i devulkanizerit	MRII
Shpejtësia rrotulluese e perzierjes	11 [rr/min]
Fuqia kryesore e motorit	18.5 [KW]
Metoda e ngrohjes	Ngrohja me vaj
Materialet e mëdha në shtypje	Automatike
Vëllimi total	6 [m ³]
Lartësia	2200 [mm]
Gjerësia	2260 [mm]
Pesha	1000 [kg]



Figura 37. Makina për zhveshjen e pneumatikut

Tabela 15. Karakteristikat themelore të makinës për zhveshjen e pneumatikut

Emërtimi	Parametri teknik
Fuqia e motorit	5.55 [kW]
Diametri i diskut	380 [mm]
Shpejtësia e rrotullimit	18.4 [rr/min]
Madhësia	1290x870x1550 [LxWxH]




Figura 38. Paraqitja skematike e procesit të përpunimit- riciklimit

Në vijën teknologjike për transportimin e granulateve përpos shiritave transportues ekziston edhe separatori sita që e ndan granulatit me madhësi më të madhe se sa ai që nevojitet për devulkanizim dhe rafinim, prandaj granulatit me madhësi më të madhe përmes shiritit transportues prapë kthehet në sistemin e thërrmimit dhe përsëritet për fraksionet e mëdha gjersa të fitohet granulacioni (fraksioni) me madhësi të dëshiruara, në kuadër të vijës teknologjike për transportimin e granulatit. Ekziston edhe ndarësi (magneti) për ndarjen e telit nga gomat, gjithashtu ekziston edhe kutia planetare për ndarjen e tekstilit që në disa pneumatikë ekziston. Kapaciteti prodhues i trajtimit – riciklimit të pneumatikëve mbeturin është 3 - 4 ton në ditë.



Figura 39. Makina për ndarjen e granulateve të pneumatikëve

Copëtimi bëhet me temperaturë që varion nga 65- 85 [°C]. Mjetet e grimcimit janë me përdorshmëri afatgjatë.




Figura 40. Llojet e granulateve të fituara

7. MUNDËSIA E PËRDORIMIT TË PNEUMATIKËVE TË RICIKLUARA

Pneumatiku i ricikluar mund të shfrytëzohet për përfitimin e prodhimeve që përdoren për:

- shtrimin e tereneve sportive,
- shtresë mbrojtëse të rrugëve,
- për shtrimin e dyshemes së palestrave të ndryshme sportive,
- kopshte të fëmijëve,
- për shtrimin e dyshemes së stallave,
- përdorim për ulje të zhurmës,
- kundër erozionit,
- për drenazhim,
- izolator, etj.

Mbeturinat e pneumatikut mund të shfrytëzohen si: burim i energjisë në fabrikat e çimentos, të gëlqeres, si dhe në procese të tjera termike në të cilat temperatura e vatrës duhet të arrijë së paku 1100 ° C. Pneumatikët jashtë përdorimit duhet të jenë të klasifikuar sipas: [11]

- madhësisë,
- llojit dhe
- dëmtimit.

Qendra shërbyese duhet të mbajë shënime për pneumatikët jashtë përdorimit dhe mbeturinat e pneumatikut sipas klasifikimit dhe sasisë së tyre.

Pneumatikët e vjetër duhet të jenë të etiketuara. Etiketa duhet të përmbajë kodin e pneumatikut mbeturinë sipas katalogut shtetëror për mbeturina, dimensionet, llojin, peshën, karakteristikat e tjera teknike dhe destinacionin. Vendi në Qendrën shërbyese ku bëhet ndërrimi i pneumatikëve, duhet të jetë i shtruar me beton. Qendra shërbyese duhet të ketë separator për derdhjen e ujërave të ndotura dhe vajrave. [11]

Në fig. 41 është treguar paisja kryesore për riveshjen e pneumatikëve të përdorur të automjeteve.




Figura 41. Pamja e pajisjes kryesore të rikuperimit (riveshjes) të pneumatikëve të përdorura të automjeteve [11]

Karakteristikat fizike të pneumatikëve, siç janë, jotosicitetit, biodegadimi, forma, masa dhe elasticiteti i bëjnë ato të përdorshme për shumë produkte dhe në forma të ndryshme – të plota (*pa u bërë përpunime – si pneumatikë të plotë*), të prera në copa, të përpunuara në formë të granulatit ose të përpunuara në formë të pluhurit. Në vitet e fundit, materialet e përfituara nga mbetjet e pneumatikëve ka shënuar rritje.

Inxhinierët e ndërtimit përdorin sasi të madhe të materialeve me përmasa të mëdha, psh. pneumatikët e plotë, copat dhe copëzat për mbrojtje akustike, për blloqe izolimi, për agregate të drenazhimit, për mbushje të ndryshme të argjinaturës dhe në deponi të ndryshme, për pneumatikë asfaltike, deri tek materiali i pistave, shtresave të sintetizuar të terreneve sportive, shtresave të shtallave (nënshtroja) të kafshëve (fig. 42 dhe fig. 43). [2]



Figura 42. Përdorimi i pneumatikëve të ricikluar për produkte të ndryshme [2]



Figura 43. Përdorimi i pneumatikëve të ricikluar për staza të terreneve sportive

7.1. Asfalt Gome

Teknologjia e re e cila është shumë e rëndësishme quhet **Asphalt Rubber** ose ndryshe **Asfalt Gome** (fig. 44). [11]

Në ditët e sotme, rivlerësimi i praktikave të mira, ndoshta edhe të vjetra, si ri-përdorimi dhe riciklimi i sendeve të përdorura dhe zhvillimi i teknologjive të reja që kursejnë burimet natyrore, janë çështje të interesit të përbashkët. Zhvillimi i atyre të ashtëquajtura “teknologji të gjelbra” sjell kursimin e shpenzimeve që lidhen me konsumimin më të pakët të burimeve jo të rinovueshme.



Figura 44. Asfalt gome [11]

Përdorimi i bitumeve të modifikuara BM dhe në rastin në fjalë Asfalt me lëndë gome apo agregate të dorës së dytë me kokrriza gomash kanë përparësinë e pa mohueshme të shpëtojnë burimet natyrore përmes riciklimit të materialeve me vlerë, aq më tepër sot që ndodhemi në kohën e kufizimit të emetimit të karbonit, zbutja e mundshme e transportit të mallrave nuk duhet të humbiste gjurmët, kur bëhej vlerësimi i ndikimit të ndërtimit të rrugëve.

Teknologjia e Asfalt Gome lindi dhe u zhvillua në një kohë kur “qëndrueshmëria” ishte larg të qenit temë e kohës, megjithatë ajo ishte një teknologji e gjelbër. Dizajni i saj i përzier lejon reduktimin e emetimit të zhurmës dhe optimizon përthithjen akustike. Shpesh është rënë dakord që veshja e bërë nga agregate të dobta dhe me më pak se 4% bitum nuk do të zgjasë shumë në kohë. Kjo përbën një nga njohuritë më të zakonshme, ku kostot e mirëmbajtjes/zëvendësimit nuk justifikojnë kursimin fillestar. Procesi i teknologjise Asfalt Gome bëhet në këto mënyra (fig. 45):



Figura 45. a) Pluhur pneumatikësh b) Shkëmb magmatik c) Shkëmb karbonatik [11]

Sot, Asfalt Gome është një zgjidhje e mbarë eksperimentuar dhe e përhapur në të gjithë botën si:

- Kanada,
- Portugali,
- Spanjë,
- Austri,
- Gjermani,
- Kinë,
- Brazil,
- Sudan,
- Afrika e Jugut dhe në
- Amerikë (ku nga viti 88' dhe deri më sot kanë qenë të përdorura më shumë se 23.000.000 pneumatikë).

Proceset që kryhen:

1. Transportimi i përzierjes së nxehtë,
2. Bluarja e pneumatikëve,
3. Shkatërrimi i materialeve përfundimtare, të marra nga vendi i punës së landfill-it,
4. Bitumi natyral është marrë nga një rafineri maksimumi 100 [km] larg nga fabrika e përzierjes së nxehtë dhe agregatet nga një distancë mesatare prej 20 [km],

Impianti është i specializuar dhe funksionon në këtë mënyrë:

1. Mulliri i cili bënë bluarjen e pneumatikëve në formë të imët,
2. Serbator i reaksionit të ngrohjes me mbështjellje termike,
3. Bitum dhe pneumatikë të përziere bashkë me Asfalt Gome i pompuar në impiant dhe i përzier me agregat,
4. Procedurë ndërtimi normale.

8. REZULTATET E PRITSHME TË HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij punimi është që të kuptojmë procesin e riciklimit dhe rigjenerimit të pneumatikëve si dhe dëmet që paraqiten në rastin kur pneumatiku bëhet i papërdorshëm dhe më pas bëhet hedhja e tyre në vende jo adekuat. Është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme të krijohen vende ku mund të bëhet grumbullimi dhe deponimi i pneumatikëve në vende të caktuara, me qëllim të menaxhimit më të mirë nga personat adekuat dhe më pas të përgatiten për riciklimin e tyre përmes metodave adekuate, si rezultat do të mbrohet natyra dhe jeta e njeriut dhe organizmave tjerë dhe njëkohësisht do fitonim produkte shumë cilësore.

Nga ky punim jam munduar të shtjelloj rolin e pneumatikut në ambient dhe në jetën tonë, se sa ka rëndësi të i kushtohet një kujdes i veçant për të e sidomos kur ajo del nga përdorimi dhe vjen deri tek nevoja për hudhjen e saj. Përmes këtij punimi kemi shtjelluar anët pozitive dhe negative të pneumatikut, çfarë dobie kemi nëse trajtohet në mënyrë adekuate, përbërjen dhe karakteristikat e saj.

Në Kosovë nuk i kushtohet shumë rëndësi pneumatikut e sidomos kur ajo bëhet e papërdorshme dhe vjen deri tek hudhja e saj. Për shkak të mungesës së madhe të fabrikave të cilët merren me përpunimin e pneumatikut dhe informacioneve të pakta që kemi për pneumatikët, ato hudhen në vende jo adekuate në mjedis si dhe disa edhe djegën në natyrë duke mos pasur parasysh rrezikun që shkaktohet nga to.

Nga hulumtimi që kam bërë rreth pneumatikëve kam pritur që të kemi një gjendje më të mirë rreth tyre. Nga kapitujt më lart që kam shtjelluar dhe analizës së bërë vërejtëm që gjendja e pneumatikëve që i përdorim në vetura nuk është e mirë si pasoj e shpenzimit të pneumatikëve ku thellësia e larave ishte shumë e ulët. Gjatë analizës shohim se kemi edhe raste ku kemi pneumatik të prodhuar në vitet e fundit por që janë të shpenzuar dhe deri te shpenzimi i tyre mund të vij si pasoj e mirëmbajtjes jo adekuate të tyre, rrugët jo të mira për vozitje si dhe mos kontrollimi i presionit etj.

Nga ky punim pres që duke parë rëndësin e pneumatikëve dhe rolin e tyre në mjedis të ju kushtohet një kujdes më i veçant dhe numri i pneumatikëve që i plotëson standartet e parapara për vozitje të rritet duke i zëvendësuar me pneumatik të ri dhe mirëmbajtje më të shpeshtë të tyre.

9. PËRFUNDIMI

Një zgjidhje efikase dhe e shpejt për menaxhimin e mbeturinave është i nevojshëm jo vetëm për të ruajtur shëndetin e njeriut por edhe mjedisin në përgjithësi. Ndotja e mjedisit nga menaxhimi jo i drejtë i mbeturinave është ndër problemet më të mëdha në kuadër të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë. Përveç nevojës për të harmonizuar ligjet vendore me ato të BE- së, vendi duhet ndryshuar situatën aktuale në të cilën mungon zbatimi i ligjeve dhe i politikave të përcaktuara. Institucionet ende nuk kanë kompetencat qartë të definuara, kështu që kjo strategji synon ndarjen e kompetencave, përcaktimin e objektivave kryesore, masat dhe projektet. [4]

Ata që ndotin mjedisin duhet të bartin koston totale të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë për koston e masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë ballafaqohet me probleme evidente. Vonesat në zgjidhjen e vështirësive për menaxhimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave kanë rezultuar me situatën aktuale e cila nga aspekti i menaxhimit është e mangët ndërsa nga aspekti financiar është e rëndë. Sfidë jashtzakonisht e madhe është krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal, me të cilin sistem do të organizohet mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave nga territori i tyre. Njëri nga problemet deri më tani ishte edhe legjislacioni dhe ndarja e kompetencave për menaxhimin e mbeturinave.

Në mënyrë që të eliminohet hudhja e pneumatikëve në natyrë dhe djegia e tyre kisha sugjeruar që të hapen më shumë fabrika për përpunimin e tyre sidomos në qytetet më të mëdha si: Prishtina, Prizereni, Peja, Gjilani, Gjakova, Mitrovica dhe përmes tyre të nderlidhen edhe qytetet tjera më të afërta sepse për momentin ekziston vetëm N.P.Sh Stagova në Ferizaj e cila edhe kjo punon me një kapacitet jo të plotë për shkak edhe të rregullorave që gjenden në vendin tonë dhe mundësia e kufizuar për eksport dhe ripërdorim të saj.

10. LITERATURA

1. Osmani, H., 2019, Menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
2. Osmani, H., 2019, Riciklimi i pneumatikëve-gomave, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
3. Bajraktari, M., 2012, Mjetet transportuese në komunikacion 2, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
4. Strategjia e republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022, Republika e Kosovës
5. Ligji për mbeturina Nr. 04/L-060, 2012, Republika e Kosovës, Prishtinë
6. Udhëzimi Administrativ mbi Kontrollimin Teknik të Automjeteve Nr.01/2018.
7. Ramos, G., Alguacil, F. J., Lopez, F. A., 2011, The recycling of end-of-life tyres. technological review
8. Reschner, K., 2008, Scrap Tire Recycling
9. A, Turer., 2012, Recycling of Scrap Tires, Middle East Technical University, Turkey
10. <https://slidetodoc.com/riciklimi-cfare-eshte-riciklimi-sht-prpunimi-i-materialit/>
11. <http://www.akm.gov.al/assets/riciklimi-i-gomave-p.point-1-pdf.pdf>
12. <http://www.elitemadzone.org/t258275-2-Gume-Tigar-Sve-njima-na-jednom-mestu>
13. [https://automobeile.ru/sq/other-vehicle-systems/characteristics-of-tires-for-cars - important-characteristics-of-winter-tires-choose-an-excellent-rubber/](https://automobeile.ru/sq/other-vehicle-systems/characteristics-of-tires-for-cars-important-characteristics-of-winter-tires-choose-an-excellent-rubber/)
14. <https://oborudow.ru/sq/prokachka/konstrukciya-i-markirovka-avtomobilnyh-shin-stroenie/>
15. <https://www.theindependentbd.com/arcprint/details/27938/2015-12-25>
16. <https://www.coursehero.com/file/p5ddmqe/Me-selektim-shum%C3%AB-vje%C3%A7ar-jan%C3%AB-zhvillua-lloje-t%C3%AB-ndryshme-t%C3%AB-drunj%C3%ABve-t%C3%AB/>